

RRETH NESH

Instituti i Ndërtimit është një ndërmarrje shtetërore që funksionon në bazë të ligjit me nr. 7582/1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” me ndryshime si dhe Urdhërit nr. 225/2004 “Për krijimin e Institutit të Ndërtimit”.

IN është një institucion me vetëfinancim në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Objekti kryesor i punës së Institutit të Ndërtimit është kryerja e veprimtarisë kërkimore shkencore, aplikative zhvillimore dhe projektuese në fushën e ndërtimit, si dhe kryerja e veprimtarive shkencore e teknologjike për të treta të tilla si oponenca, ekspertiza, kurse kualifikimi, vlerësime konformiteti dhe kontrole për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.

Në referencë të Ligjit 7582/1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” me ndryshime, Organi drejtues i Institutit të Ndërtimit është Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues është organ kolegjal që realizon drejtimin e veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore. Anëtarët e Këshillit Drejtues mes tyre dhe titullari i institucionit emërohen nga ministri. Anëtarët e Këshillit Drejtues si rregull ushtrojnë edhe funksionet drejtuese teknike në ndërmarrje.

Këshilli Drejtues shqyrton probleme të ndryshme vetëm në rastet kur është e pranishme jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Ai i merr vendimet me shumicë votash të anëtarëve që e përbëjnë. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e drejtorit është përcaktuese. Këshilli Drejtues mban librin e vendimeve dhe procesverbal, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e tij.

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes shtetërore merr vendime kolegjiale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për këto çështje kryesore:

1. Për krijimin ose shkrirjen, bashkimin ose ndarjen e filialeve.
2. Për pjesëmarrjen e ndërmarrjes shtetërore në kapitalin e ndërmarrjeve dhe të shoqërive të tjera, vendase a të huaja.
3. Për përcaktimin e pagave të punës, rritjen e tyre dhe shpërblimin suplementar të punonjësve.
4. Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme të marrjes në punë dhe të largimit nga puna të punonjësve.
5. Për shkarkimin nga funksionet teknike të një anëtari të Këshillit Drejtues me propozim vetëm të drejtorit të ndërmarrjes.
6. Për shitjen dhe dhënien me qira të mjeteve kryesore të saj.
7. Për lidhjen e kontratave të huadhënies
8. Për lidhjen e kontratave të huamarrjes në tregun kombëtar ose në tregje ndërkombëtare.
9. Për rregulloren e brendshme të funksionimit të ndërmarrjes dhe problemet sociale që lidhen me kushtet e përgjithshme të punës.

10. Për miratimin e llogarive vjetore dhe të raportit vjetor të veprimtarisë ekonomike e financiare të ndërmarrjes.

Drejtori i Institutit të Ndërtimit përfaqëson ndërmarrjen në të gjitha marrëdhëniet e saj juridike dhe administrative. Ai nënshkruan, nën përgjegjësinë e tij, veç të tjerave, edhe kontratat që lidhen nga ndërmarrja.

Drejtori i IN-së ka të drejtën të japë urdhëra dhe udhëzime dhe të vendosë sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shërbimet që Instituti kryen janë:

- hartimi i projekteve ndërtimore
- kryerja e opioncave teknike, akt ekspertizave, kurse kualifikime, vlerësime konformitet dhe kontrole për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.

Në përputhje dhe me aktet ligjore në fuqi të gjitha Kërkesat ankesat trajtohet nga ana e Institutit të Ndërtimit sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Kur kërkesa është e paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e saj, Autoriteti Publik kontakton menjëherë personin për të bërë sqarimet e nevojshme, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës.

Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës Autoriteti Publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë Autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar.

Kërkesat e ndryshme mund të dërgohen në adresën postare: Instituti i Ndërtimit Rruga Myslym Keta Brar Tirane ose në adresën postare constructionsinstitute@yahoo.com

Në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Institutit të Ndërtimit çdo i interesuar ka të drejtë të drejtohet Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe gjykatës administrative të shkallës së Parë në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ.